

Njoftim për njësitë akademike të UP "Hasan Prishtina"

Në mënyrë që të sigurohemi se stafi akademik po zbaton metoda transparente vlerësimi dhe e kryen punën në përputhje me Statutin e UP-së dhe nevojat e komunitetit akademik:

- I. Të gjitha njësitë akademike obligohen që t'i publikojnë në uebfaqet e tyre:
 1. Syllabuset (e rishikuara) të lëndëve të semestrit dimror dhe atij veror 2015/2016, në të cilat duhet të paraqiten saktë koha e mbajtjes së kolokviumeve, testeve periodike, afati i dorëzimit të eseve, seminareve etj
 2. Orarin e ligjëratave e ushtrimeve
 3. Orarin e konsultimeve të stafit akademik.
 4. Orarin e provimeve të afatit të nëntorit dhe janarit.
- II. Informacioni nga pika I (nënpikat 2, 3 dhe 4) duhet të përcillet në Rektorat në formë elektronike dhe të shtypur.
- III.. Stafi akademik duhet t'i informojë studentët për informacionet nga pika I, të paktën duke i referuar tek uebfaqet e njësive përkatëse.
- IV. Për çdo shkelje eventuale nga stafi akademik, dekanët obligohen të marrin masa adekuate.

Prof. dr. Ramadan Zejnullahu